

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS- kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Nebojsa Boriçiq, kryetar, Erdogan Haxhibeqiri dhe Shukri Sylejmani, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sherif Krasniqi, procesmbajtës, në çështjen administrative sipas padisë së paditësit L.Sh, nga, kundër të paditurës kundër të paditurës Agjencia Kadastrale e Kosovës në Prishtinë, në çështjen administrative caktimi i masës së përkohshme , duke vendosur lidhur më kërkesën e paditësit për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit Prishtinë, AA-UZH nr. 222/2017 datë 31.05.2017, në seancën jopublike të mbajtur më 30.10.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar kërkesa e paditësit L.Sh. nga....., për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative AA-UZH nr. 222/2017 datë 31.05.2017.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës –Departamenti për çështje Administrative AA-UZH nr. 222/2017 datë 31.05.2017, është refuzuar si e pa bazuar ankesa e paditësit-propozuesit L.Sh. ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative A.nr.1495/2016 datë 04.05.2017, me të cilën është hudhur propozimi i propozuesit/Paditësit / L.Sh, nga Komuna, e paraqitur kundër të paditurës /kundër propozuesit/ Zyra Rajonale në Prizren dhe Agjencia Kadastrale e Kosovës, me të cilën ka kërkuar masën e përkohshme dhe me të cilën detyrohet e paditura të bënë përmirsimin e gabimit në elaboratin kadastral, ku në vend të ngastrës kadastrale nr. 5681/2, të shënohet ngastra kadastrale nr. 5681/1, në certifikatën e pronësisë, ngastra në vendin e quajur “.....” K.K. deri në vendosjen meritorë të kësaj çështje nga gjykata.

Paditësja, në afat ligjor kësaj Gjykate i ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, me të cilin e konteston ligjshmërinë e aktgjykimit për shkak të shkeljes drejtës materiale, dhe shkeljes së dispozitave procedurale me propozim që aktgjykimi i Gjykatës së Apelit AA.nr. 222/2017 i dt. 31.05.2017 të anulohet dhe çështja të kthehet në rivendosje në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për çështje administrative.

Gjykata Supreme e Kosovës në bazë të nenit 53 të Ligjit për Konfliktet Administrative , ka mbajtur seancën e kolegjit dhe pas vlerësimit të aktgjykimit dhe shqyrtimit të shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

Kërkesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se Me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës – Departamenti për çështje Administrative AA-UZH nr. 222/2017 datë 31.05.2017, është refuzuar si e pa bazuar ankesa e paditësit-propozuesit L.Sh. ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative A.nr.1495/2016 datë 04.05.2017, me të cilën është hudhur propozimi i propozuesit/Paditësit / L.Sh, nga Komuna e, për caktimin e masës së përkohshme.

Gjykata Supreme e Kosovës, me rastin e shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim e jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, vlerëson si të drejtë aktvendimin e gjykatës së shkallës së dytë kur paditësit-propozuesit i refuzon si të pa bazuar ankesën, duke e vërtetuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Me dispozitën e nenit 13 të Ligjit për Konfliktet Administrative, përcaktohet qartë se “ *konflikti administrativ mund të fillohet vetëm kundër aktit administrativ të nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, ose kundër aktit administrativ të nxjerrë në shkallë të parë, kundër të cilit nuk është lejuar ankimi*”. “*Konflikti administrativ mund të filloj edhe kur organi kompetent nuk ka nxjerr akt përkatës administrativ sipas kërkesës ose ankesës së palës nënë kushtet e parashikuar me këtë ligj*” ashtu siç parashihet në dispozitën e nenit 14 të LKA.

Po ashtu, sipas dispozitës së nenit 22 par.2 të po të njëjtit ligj, “*me kërkesën e paditësit, organi, akti i të cilit ekzekutohet, gjegjësisht organi që është kompetent për ekzekutim, mund ta shtyjë ekzekutimin deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi do t'i sillte dëm paditësit,*

i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar.”

Duke marr parasysh dispozitat e lartë theksuarat të Ligjit për Konfliktet Administrative, si dhe situatës faktike përshkruar si më lartë, paditësi siç rezulton nga shkresat e çështjes nuk ka shterr mjetet juridike sipas ankesës apo kërkesës në organet administrative që pastaj të ketë të drejtë të hap konflikt administrativ dhe ushtrimin e kërkesës për shtyrjen e aktit përfundimtar gjerë në vendosje në mënyrë meritore sipas padisë ashtu siç parashifet me dispozitën e nenit 22 të Ligjit për Konflikte Administrative.

Qëndrimin juridik të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore , si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tersi e aprovon edhe kjo gjykatë, ngase vendimet e atakuara nuk janë përfshi me shkelje të drejtës materiale dhe të drejtës procedurale siç pretendon paditësi në kërkesë.

Gjykata Supreme e Kosovës, gjithashtu gjeti se gjykata e shkallës së dytë në këtë çështje administrative dhe juridike, ka zbatuar drejt dispozitat e procedurës administrative dhe se pohimet në kërkesën e paditësit për rishqyrtimin e jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor janë të pa bazuara sepse ato nuk ndikojnë në nxjerrjen e vendimit të ndryshëm të gjendjes faktike nga ajo që ka gjetur gjykata e shkallës së dytë. Po ashtu, Gjykata Supreme ka vlerësuar se e drejta materiale është zbatuar drejtë nga gjykata e shkallës së dytë dhe se ligji nuk është shkelur në dëm të paditësit.

Nga se u theksua si më lartë, e në bazë të nenit 54 par.1 të Ligjit për konfliktet administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREM E KOSOVËS PRISHTINË

ARJ-UZVP NR. 52/2017 DATË 30.10.2017

Procesmbajtës,

Sherif Krasniqi

Kryetar i kolegjit,

Nebojsa Boriçiq